



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data 6650/1

Nr. 28.08.2023 Prot.

FTESË PËR NEGOCIATË  
PËR  
AGJENCITË E SPECIALIZUARA/ORGANET E MEDIAVE VIZIVE PËR PRODHIMIN E  
VIDEOVE/SPOTE EDUKUESE, INFORMUESE DHE NDËRGJEGJËSUERE, NË KUADËR TË  
ZGJEDHJEVE TË PJESSHME TË 24 SHTATORIT 2023.

Në mbështetje të nenit 7 pika 1/b, të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", të VKM-së Nr.1195, datë 05.08.2008 "Për blerjen, zhvillimin, prodhimin dhe bashkëprodhimin e programeve ose reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar dhe për kontratat, për kohën e transmetimit, nga organet e administratës shtetërore" dhe vendimit nr. 726 datë 23.08.2023 "Për miratimin e Programit të Edukimit, Informimit dhe Ndërgjegjësimit të Zgjedhësve, për zgjedhjet për Kryetar Bashkie Kukës", të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të realizojë "prodhimin e videove edukuese, informuese dhe ndërgjegjësuese" për Zgjedhjet për Kryetar Bashkie Kukës të datës 24 shtator 2023.

OBJEKTI

"Prodhimi i videove (spote) në kuadër të informimit, edukimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve për Zgjedhjet për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 shtator 2023.



**Periudha e realizimit:** 5 (pesë) ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

**Fondi limit i përcaktuar:** fondi limit i procedurës është në vlerën 1.000.000 (një milion) lekë me Tvsh.

**Afati përfundimtar** për paraqitjen e dokumentacionit nga agjencitë e specializuara është më datë **01.09.2023 (5 ditë) ora 16:00** nga momenti i publikimit dhe dërgimit të ftesave.

Dokumentacioni/ofertat duhet të vijnë të gjitha të mbyllura në zarf jotransparent, në një ditë të vetme, të firmosura dhe vulosura në emrin dhe adresën e subjektit dhe me shënimin “Mos e hapni”, me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm komisioni i vlerësimit të ofertave dhe jo përpara datës **04.09.2023, ora 10.00**.

Në rast të kundërt ato do të refuzohen dhe do të kthehen të pahapura.

Rrjedhimisht jeni të lutur të paraqisni pranë Autoritetit tonë kontraktor:

Emri: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Adresa: Rruga “Ibrahim Rugova”, Nr 4

Adresa e Internetit: [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al)

**Në emër të Komisionit për ndjekjen e procedurave me objekt “Për prodhimin e spoteve televizivë” kriteret do të jenë si më poshtë.**

**Gjuha për hartimin e ofertave është: Shqip**

## 1. TERMAT E REFERENCËS

**Qëllimi i kësaj fushate është:** Informimi, Edukimi dhe Ndërgjegjësimi i Zgjedhësve të Bashkisë Kukës, me qëllimin final për tu ardhur në ndihmë të gjithë zgjedhësve, që të informohen për



hapat e procesit zgjedhor dhe mënyrën e plotësimit të fletës së votimit për zgjedhjet për Kryetarin e Bashkisë Kukës.

**Përshkrimi:**

**Prodhimin e 1 video (Spot) dhe imazheve statike korresponduese, në kuadër të informimit, edukimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve për Zgjedhjet për Kryetar Bashkie në Kukës të datës 24 shtator 2023.**

Video dhe imazhet informuese, duhet të përmbajnë në fokus informacion të plotë dhe të detajuar për procesin zgjedhor të datës 24 shtator 2023.

Spoti duhet të realizohet në përputhje me standardet dhe teknikat më të avancuara të filmimeve dhe duhet të jetë i përshtatshëm për formatin e transmetimit Full HD.

**Shërbimet që kërkohen të realizohen:**

Prodhimi i videos duhet të jetë në format për transmetim televiziv dhe për shpërndarje në rrjetet sociale. Video duhet të ketë përmbajtjen e qëllimit të vendosur në këtë ftesë për negociatë, sipas kërkesës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, duke përfshirë të gjitha kategoritë e zgjedhësve.

**Karakteristikat:**

- Gjatësia mesatarisht 45 - 60 sekonda.
- Cilësia full HD.
- Kualiteti 4K.
- Voice Over Profesional.
- Video informuese duhet të jetë gjithsej 1 (një), shoqëruar nga një seri imazhesh statike me mesazh zgjedhor.



**Për realizimin e videos së mësipërme kërkohet paraprakisht:**

Operatori ekonomik duhet të realizojë shërbimet e përcaktuara më lart në funksion të objektit Prodhimin e video (Spot) në kuadër të Zgjedhjeve për Kryetar Bashkie Kukës të 24 shtatorit 2023.

Operatori duhet të dorëzojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, materialet e përgatitura në një kopje në CD në format të editueshëm.

Spoti duhet të realizohet në përputhje me standardet dhe teknikat më të avancuara të filmimeve me kualitet 4K, Full HD dhe gjuhën e shenjave.

Pamjet që do të regjistrohen gjatë periudhës së xhirimeve duhet të jenë ekskluzive.

Efektet audio dhe efektet muzikore në përmbajtje të materialit përfundimtar duhet të jenë të trajtuara posaçërisht për Spotin Tv dhe të zotërojnë të gjitha të drejtat e rezervuara të përdorimit të pakufizuar si në aspektin gjeografik ashtu edhe në aspektin kohor.

Spoti duhet të përmbajë sloganin kryesor, logon zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe website zyrtar të KQZ-së.

Operatori Ekonomik duhet të sigurojë të gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizimin e Spotit, transportin, stafin dhe lejet e xhirimit.

Materialet e spotit TV duhet të dorëzohen në Formatin HD.

Materialet e përshtatura për transmetim duhet të dorëzohen në format VIDEO HD1080, Format MP4 kopje në DVD/USB.

**2. INFORMACION DHE KËRKESA SPECIFIKE NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK**

**KRITERET E PRANIMIT/KUALIFIKIMIT**

**Kriteret e përgjithshme:**

**Dokumentacion ligjor që duhet paraqitur për të plotësuar kriteret kualifikuese:**





- a. Ekstrakti historik i regjistrit tregtar.
- b. Vërtetim për statusin aktiv.
- c. Deklaratë mbi konfliktin e interesit.
- d. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur.
- e. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore.
- f. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike.
- g. Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme.
- h. Kontrata pune dhe kontrata bashkëpunimi.
- i. Vërtetim e xhiros për një ose dy viteve të fundit.
- j. Kopje të bilancit për vitin 2022.
- k. Kontrata të ngjashme jo më pak se 40% të fondti limit.
- l. Vërtetim disponibiliteti të personelit kryesor të nevojshëm për të zbatuar objektin e procedurës, dhe kontratat e shërbimit/bashkëpunimit ose kontratat individuale të punës,
- m. CV-të e tyre sipas kategorive të përcaktuara.

#### **Kriteret e përgjithshme financiare, kapaciteti financiar:**

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të bilancit për periudhën e vitit 2022, të deklaruar pranë autoriteteve përkatëse tatimore. (më mirë vërtetim xhiro 1 ose 2 vitet e fundit).

#### **Kapacitet teknik dhe profesional**

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit për negociata, kontrata të ngjashme në një vlerë jo më pak se 40% të fondit të parashikuar për këtë shërbim. Kjo do të vërtetohet me dokumentet e mëposhtme:
  - *Për kontrata me një ent publik, kërkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës*



ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

3. Personeli Kryesor. Shoqëria duhet të disponojë personelin kryesor të nevojshëm për të zbatuar objektin e procedurës, dhe të paraqesë kontratat e shërbimit/bashkëpunimit ose kontratat individuale të punës, CV-të e tyre sipas kategorive të përcaktuara më poshtë:

- 1 (një) Regjizor
- 1 (një) Skenarist
- 1 (një) Operator

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre të lëshuara jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e publikimit të njoftimit për negociata. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Përzgjedhja e ofertave do të bëhet sipas pikës nr. 7 dhe 12, të VKM nr.1195 datë 05.08.2008.

#### 4. KRITERET E VLERËSIMIT

- Kriteret e përgjithshme: 10
- Kapaciteti financiar: 10
- Kapacitet teknik dhe profesional: 30
- Oferta financiare e shoqëruar me Projekt propozimin për realizimin e kontratës: 50

Vlerësohet me 30 pikë dokumentacioni ligjor i paraqitur.



**Vlerësohet me 20 pikë eksperiencia e mëparshme e operatorit ekonomik.**

**Vlerësohet me 50 pikë çmimi i ofruar nga organi i masmedias/agjencia e specializuar.**

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në lekë, me TVSH.

Ofertuesit kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e hapjes së ofertave, përfaqësuesit apo personat me autorizim.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Zyra e Protokollit, përpara orës së përcaktuar.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë e cila do të dorëzohet përtej afatit të përcaktuar dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Kjo ftesë për negociata do të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në adresën: [www.kqz.gov.al](http://www.kqz.gov.al)

**Jemi në pritje të konfirmimit tuaj për negociim.**

